



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1;

E-mail: [klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al); web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 792/\_\_\_Prot.

Tiranë, më 16/07/2021

**V E N D I M**

**Nr. 68, Datë 16/07/2021**

**PËR**

**AUDITIMIN TEMATIK PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE NË  
LIDHJE ME: VENDIMIN NR. 32, DATË 02.07.2020 TË KOMISIONIT SHTETËROR  
TË RINDËRTIMIT; PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT SI DHE PËR  
ZBATIMIN E PUNIMEVE NËOBJEKTIN "RIKONSTRUKSIONI DHE SHTESA  
ANËSORE DHE PALESTRËS SË RE NË SHKOLLËN 9 VJECARE "14 NËNTORI"**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shtetit për Rindërtim, në Bashkinë Durrësdhe në Institutin e Ndërtimitnë zbatim të autorizimit nr. 792/1, datë 27.08.2020, autorizimit nr. 792/2, datë 27.08.2020, dhe autorizimit nr. 792/4, datë 03.09.2020, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt òMbi zbatimin e procedurave ligjore në lidhje me Vendimin nr. 32, datë 02.07.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, për objektet arsimore të cilat janë përfshirë në listën e objekteve që do të rindërtohen dhe rikonstruktohen në Bashkinë Durrësò, òMbi zbatimin e procedurave ligjore në prokurimin me objekt òRikonstruksioni dhe shtesa anësore dhe palestrës së re në shkollën 9 vjecare ò14 Nëntoriö, si dhe òMbi zbatimin e punimeve në objektin òRikonstruksioni dhe shtesa anësore dhe palestrës së re në shkollën 9 vjecare ò14 Nëntoriö,u konstatuase, në kushtet kur procedurat e ndjekura për vlerësimin e 11 objekteve të Bashkisë Durrës, që kanë pësuar dëme gjatë tërmetit, janë kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, dhe si pasojë edhe dokumentet – produkt i këtyre procedurave (akt ekspertizat, oponencat) nuk janë në përputhje me kriteret ligjore, atëherëprocesi i vendimmarrjes (veçanërisht për prishjen e detyruar të objekteve) është i pabazuar ligjërisht,duke mbartur njëkohësisht riskun që të jetë edhe e gabuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 òPër Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò,

**VENDOSA**

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Mbi zbatimin e procedurave ligjore në lidhje me Vendimin nr. 32, datë 02.07.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, për objektet arsimore të cilat janë përfshirë në listën e objekteve që do të rindërtohen dhe rikonstruktohen në Bashkinë Durrës, të ushtruar në Ministrinë e Shtetit për Rindërtim, Bashkinë Durrës dhe në Institutin e Ndërtimit, sipas autorizimit nr. 792/1, datë 27.08.2020, autorizimit nr. 792/2, datë 27.08.2020, dhe autorizimit nr. 792/4, datë 03.09.2020.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **A.1 Për zbatimin e punimeve në objektin “Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës (inspektim në terren) nga auditimi rezultoi sa më poshtë vijon:**

#### **1. Gjetje nga auditimi:**

-Në objektin “Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe objekteve në terren, u konstatua se dy objektet e shtesave anësore dhe objekti i palestrës kishin pësuar ulje, të cilat variojnë nga 2.75 cm deri në 19.10 cm (evidentuar në raportin gjeoteknik realizuar në datë 29.06.2018 nga konsuleti “TTS& EC”). Këto ulje u verifikuan vizualisht në objekt edhe nga grupi i auditimit, ku u konstatua se kishte disnivel midis godinës ekzistuese të shkollës dhe dy objekteve shtesë të ndërtuara në zbatim të kësaj kontrate. (Trajtuar në faqet nr 42-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

-Në objektin “Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe objekteve në terren, **për sa i përket pasojave nga tërmeti, konstatohet se në dy shtesat e reja dhe në palestër, ka disa çarje-plasaritje diagonale në muraturë**, të cilat dyshohet se kanë ardhur si pasojë e cilësisë së dobët të materialeve të ndërtimit dhe mungesës së realizimit të brezave sizmik prej betoni në muraturë. Këto çarje janë më evidente tek muratura e palestrës, në afërsi të deryve të brendshme të shtesave anësore dhe në pjesën ku bashkohen shtesat anësore me godinën ekzistuese, pranë fugës (paraqitur në foton 3 në anekse). **Ndërsa ulja e dy objekteve shtesë, është shfaqur që në vitin 2018, siç vërtetohet dhe nga studimi gjeoteknik i realizuar në 29.06.18.** (Trajtuar në faqet nr nr 42-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**1.1 Rekomandimi:** Në kushtet kur uljet e objekteve të reja, janë evidentuar para tërmetit, nga Bashkia Durrës të merren masa për ngritjen e një grupi pune të specializuar ose kontraktimin e konsulentëve të kualifikuar, për të realizuar një akt ekspertizë të thelluar, me qëllim vlerësimin e dëmtimeve dhe përcaktimin e origjinës së shkaqeve të uljeve të objekteve shtesë dhe palestrës në shkollën “14 Nëntori” Durrës (zbatimi i punimeve ose nga tërmeti), në mënyrë që në përfundim akti i ekspertizës të mund të ofrojë një pamje të qartë të faktit nëse dëmet e konstatuara do të kishin ndodhur edhe nëse nuk do të kishte ndodhur tërmeti.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, rezulton, që për këtë objekt të jetë dhënë leja e zhvillimit me Nr. 151, datë 04.03.2019, ose 525 ditë nga fillimi i punimeve, ose 302 ditë nga përfundimi i punimeve, ndërsa nuk është

dhënë leje ndërtimi për këtë objekt, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 òPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò Neni 39, òLeja e ndërtimitò. Në dosje rezultuan dokumente, të cilat tregojnë që punimet kanë vazhduar normalisht edhe pa patur leje ndërtimi dhe Bashkia Durrës, apo njësitë e varësisë, që janë të ngarkuara për inspektimin e punimeve të ndërtimit, nuk kanë marrë masa për kryerjen e vëzhgimeve për zhvillimet në territor, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 òPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò Neni 51 òInspektimiò.

Kryerja e punimeve në mungesëtë lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ndikon në mospërfitim të kreditimit të TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e blera në funksion të punimeve të situacionuara nga subjekti ndërtuesòRNò SHPK & òV - Eò SHPK, i cili nuk duhet të kishte filluar punimet në mungesë të saj. Kjo parashikohet qartë në dispozitat ligjore mbi taksat dhe tatimet dhe konkretisht pika 8, gërma d), e nenit 20, të Udhëzimit nr. 6 datë 30.01.2015 òPër tatimin mbi vlerën e shtuarò, i ndryshuar. Kreditimi i padrejtë i TVSH-së, ul padrejtësisht detyrimet e pagueshme në buxhetin e shtetit nga subjekti ndërtues, kupër këtë objekt vlera mund të shkojë deri në 95% të TVSH-së së llogaritur në situacionete prera ose rreth **12,487,925 lekë**. (Trajtuar në faqet nr 42-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**2.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Durrës të merren masa, për të ngritur grup pune për analizimin e shkaqeve që kanë sjellë problemet e konstatuara, me qëllim dhënien e masave administrative për personat e ngarkuar me përgjegjësi, bazuar në nenin 52 të Ligjit Nr. 107/2014 òPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò.

Nga Bashkia Durrës të merren masa që për të gjitha rastet në vijim, para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.2 Rekomandimi:** Nga Bashkia Durrës të merren masat që një kopje e dokumentacionit për objektin òRikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën ò14 Nëntoriò, t'ò dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të vijuar procedurat e vlerësimit/rivlerësimit konform përcaktimeve ligjore dhe rikuperimin e vlerës së TVSH-së së munguar në buxhet për këtë objekt.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit rezultoi se territori ku është kryer ndërtimi i ri bën pjesë në Zonën Arkeologjike òBò të qytetit Durrës. Për këtë ndërtim të ri, në këtë zonë, rezultoi se nuk është kryer asnjë vëzhgim intensiv paraprak, asnjë sondazh arkeologjik apo forma të tjera të testimit nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, si dhe asnjë miratim me shkrim nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, në kundërshtim me VKM-së nr. 237, datë 23.03.2011, òPër miratimin e rregullores “Për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit”ò, neni 3 dhe 4;

Mosndjekja e këtyre procedurave, mbart riskun e mosrishikimit të projektit, kur gjatë zbatimit të projektit ndërtimor zbulohen gjetje të rëndësisë së veçantë, duke rrëzuar dëmtimin deri në humbje të monumenteve dhe strukturave arkeologjike. (Trajtuar në faqet nr 42-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Durrës të merren masa, për të ngritur grup pune për analizimin e pasojave që kanë sjellë veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, sa i takon realizimit të punimeve të objektit pa miratimin nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, me

qëllim dhënien e masave administrative për personat e ngarkuar me përgjegjësi, sipas nenit 49 të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, i ndryshuar òPër trashëgiminë kulturore.

Me qëllim mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, nga Bashkia Durrës të merren masa që për të gjitha rastet e ndërhyrjeve në zonat arkeologjike të qytetit të Durrësit, të veprohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi..

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit rezulton se për objektin “*Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës*”, me vlerë të preventivuar 108,273,600 lekë nuk është kryer oponenta teknike e projektit të zbatimit, në kundërshtim me nenin 6, të Ligjit nr. 8402 òPër disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar. Oponenta teknike shërben për certifikimin e projektit të zbatimit nga Instituti i Ndërtimit, si institucioni përgjegjës i specializuar dhe moskryerja e saj mbart riskun e një projekti të hartuar në kundërshtim me Kushtet Teknike të Projektimit dhe legjislacioni në fuqi. (*Trajtuar në faqet nr 42-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**4.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Durrës të merren masa, për të ngritur grup pune për analizimin e pasojave që kanë sjellë veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, sa i takon realizimit të punimeve të objektit sipas një projekti pa oponente teknike, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi, sipas nenit 15, të Ligjit nr. 8402 òPër disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar.

Nga Bashkia Durrës të merren masa për kryerjen e oponentës teknike për të gjithë projektet e planifikuara për zbatim, me vlerë preventivi mbi 100 milion lekë me tvsh.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, rezultoi se objekti “*Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës*”, është projektuar pa patur detyrë projektimi dhe pa patur studimin gjeologjik të terrenit në të cilin do të ndërtohen shtesat e objektit dhe palestra e re, në kundërshtim me Ligjin nr 107/2014 òPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Mungesa veçanërisht e studimit gjeologjik implikon projektimin jo të saktë të themeleve dhe të strukturës së objekteve. (*Trajtuar në faqet nr 42-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**5.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Durrës të merren masa, për të ngritur grup pune për analizimin e pasojave që kanë sjellë veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, sa i takon hartimit të projektit të zbatimit pa patur studim gjeologjik, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Nga Bashkia Durrës të merren të gjitha masat për realizimin e detyrës së projektimit dhe studimeve gjeologjike/gjeoteknike të detajuar për çdo projekt të ri që do të realizojë në të ardhmen.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **6. Gjetje nga auditimi:**

**6.1** Në objektin “*“Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës.*” nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike dhe në terren, u konstatua se, **cilësia e punimeve paraqitet jo në standardet e një shkolle e cila ka përfunduar rikonstruksion dhe ndërtimin e saj, vetëm 2 vjet më parë, për asryet në vijim:**

- Përveç dëmtimeve që ka dhënë tërmeti në muraturën e godinave të reja, konstatohet se suvaja dhe boja në disa pjesë të brendshme të godinës është e degraduar (*paraqitur në foton 3 dhe 5 në anekse*).

-Shtresa e dyshemesë në disa vende nuk është në nivel.

- Mungon uji i ngrohtë në ambjentet e tualeteve, ku konstatohet se në projekt preventiv ishte parashikuar për t'u realizuar në sasinë prej 6 copë zëri "FV bolier 80 litër, ujë te ngrohte", por është hequr si sasi gjatë ndryshimeve sipas procesverbalit të punimeve që hiqen dhe që shtohen, datë 09.04.2018. Nëpërmjet këtij proceverbali janë hequr dhe punimet të fasadës së jashtme të objektit "F.V zgara dekorativa hekuri me figuracion dekorativ (profile100mmx20mmx1.5mm dhe 60 mm x 20 mm x 2mm)" në sasinë 1.30 ton dhe "F.V panele brisolei vertikale me strukture profil alumini80x80 dhe veshje me rrjete te preforuar te lyster me boje me pjekje" në sasinë 20 copë; Gjithashtu konstatohet se ashensori nuk është funksional.

**6.2** Në vijim rezultoi se, **janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion**, të cilat si më poshtë:

- Kaldaja me vlerë 850,000 lekë është vendosur në objekt me fuqi 180,000 kilokalori/orë që korrespondon me 209.2 kw dhe jo 500 kw, siç është kërkuar në projekt-preventiv..

- Zëri ÷Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suvaö është kryer sipas zërit ÷Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suvaö.

- Pllakat grez porcelanato, nuk janë të përmasave 60 x 60 cm, siç janë kërkuar në projektpreventiv.

- Zëri Dyer druri zemër dërrase, kasë dërrase, ½ xhamö, nuk janë realizuar siç janë kërkuar në projekt preventiv.(*Trajtuar në faqet nr 42-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**6.1 Rekomandimi:**Nga Bashkia Durrës të merren të gjitha masat për ngritjen e një sektori të veçantë, për ndjekjen e kontratave që realizohen nga ky institucion, ku përveçse të kontrollohet në mënyrë të imtësishme realizimi i zërave sipas volumeve të preventivit, të kontrollohet edhe cilësia e materialeve të përdorura në objekt dhe specifikimet teknike të pajisjeve të vendosura.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**A.2 Mbi zbatimin e procedurave ligjore nga Instituti i Ndërtimit dhe Bashkia Durrës, në lidhje me Vendimin nr. 32, datë 02.07.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, sa i përket objekteve arsimore që janë përfshirë në listën e objekteve që do të rindërtohen dhe rikonstruktohen në Bashkinë Durrës, rezultoi sa më poshtë vijon:**

## **7. Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi rezultoi se, pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019, me Urdhër të titullarit të Institutit të Ndërtimit me nr. P3266 Prot., datë 26.11.2019, ÷Mbi ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e dëmtimeve të ndodhura pas tërmetit të datës 26.11.2019ö, u përcaktuan 19 specialistë të IN, 29 specialistë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe 30 specialistë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me qëllim që, në bashkëpunim me institucionet e tjera të emergjencave civile të konstatojnë dhe të verifikojnë gjendjen konstruktive të ndërtesave të dëmtuara pas tërmetit. Pas përfundimit të verifikimeve në terren, nga IN janë hartuar akt-konstatimet përkatëse, të cilat i janë përcjellë Bashkisë Durrës me shkresën nr. 852/1 Prot., datë 22.12.2019, e protokolluar në Bashkinë Durrës me nr. 18302 Prot., datë 23.12.2019. Nga auditimi rezultoi se dokumentat e aktekspertizave **nuk** janë protokolluar në përputhje me nenin 13, të Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor në

Republikën e Shqipërisë, të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në mbështetje të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 òPër arkivatò, konkretisht:

- Me Urdhrat nr. 309/1 Prot., datë 04.02.2020 dhe nr. 309/3 Prot., datë 05.02.2020, janë ngritur grupet e punës për verifikimin dhe inspektimin për objektet arsimore të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, për Bashkinë Durrës. Këto grupe, do të bënin inspektimin dhe vlerësimin teknik të objekteve arsimore sipas listës së vënë në dispozicion nga Bashkia Durrës, ku do të shpreheshin mbi gjendjen teknike të objekteve duke u bazuar në KTP dhe në Eurokodet në fuqi. Vihet re se, secili urdher ka një paragraf ku shprehet se: *òAktekspertizat, pas verifikimeve të bëra nga ana e Koordinatorës dhe firmosjes nga ana e titullarit të IN, do të kalojnë në protokoll dhe do të dërgohen pranë Bashkisë Durrës”, në kundërshtim kjo me nenin 13 të òNormave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, ku përcaktohet se: òDokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluarò, **dhe jo përpara sikundër ka ndodhur.** (Trajtuar në faqet nr 58-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**7.1 Rekomandimi:** Instituti i Ndërtimit, për rastet e konstatuara, të marrëmasa, për të ngritur grup pune për analizimin e pasojave që kanë sjellë veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, sa i takon moszbatimit të kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 òPër arkivatò dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

Në vijim, me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara për ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore si dhe shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, nga IN të merren masat që për të gjitha rastet në vijim, çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor; dhe t*ò* paraqitet titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi të jetë protokolluar dhe jo ndryshe.

**Menjëherë**

## **8. Gjetje nga auditimi:**

Sa i takon verifikimit të fillimit të procedurave të ndjekura për 11 objektet subjekt i këtij auditimi, rezultoi se:

Bashkia Durrës, me shkresën nr. 1684, datë **31.01.2020** òKërkesë për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar për disa shkolla të Bashkisë Durrësò (**nënshkruar nga ZhV, zëvendëskryetar**), protokolluar në IN me nr. 309, datë 04.02.2020, i ka kërkuar IN-së kryerjen e akt ekspertizave të thelluara për 14 objekte arsimore, ndërmjet të cilave janë edhe:

1. shkolla 9 vjeçare ò14 nëntoriò (rindërtim)<sup>1</sup>; dhe
2. konvikti i shkollës òBernardina Qerraxhijaò (rikonstruksion)<sup>2</sup>.

Nga verifikimi rezultoi se, kjo kërkesë bazohet në kërkesat e DRAP/Durrës me nr. 33 prot, datë 14.01.2020, si dhe ZAV/Durrës me nr. 69, datë 15.01.2020. Vumë re se:

-Shkresa nr. 33, datë 14.01.2020 e DRAP Durrës, me lëndë “*Kërkesë për vënie në dispozicion të akt ekspertimeve për shkollat e Qarkut Durrës*”, i drejtohet Bashkisë Durrës për vënie në dispozicion të akteve të ekspertimit<sup>3</sup> të thelluara për gjithë shkollat e Qarkut Durrës; ndërsa

-Shkresa nr. 69, datë 15.01.2020 e ZVA Durrës, me lëndë òKërkesë mbi akt e konstatimit nga tërmeti” në fakt i drejtohet DRAP Durrës për vënie ne dispozicion te akteve te inspektimit

<sup>1</sup>Object I këtij auditimi

<sup>2</sup>Object I këtij auditimi

<sup>3</sup>Termi nuk është i saktë për të kuptuar nëse përhet fjalë për aktet e inspektimit apo aktet e ekspertizës (së thelluar)

për 6 shkollat si më poshtë (**dhe jo për 14 sikundër listohen** në shkresën nr. 1684, datë 31.01.2020):

- 14 Nëntori
- Bedrie Bebeziqi
- Hasan Koci
- Shaqe Mazreku
- Vëllezërit Haradinaj Rrashbull
- Xhelal Shtufi Shkafane

Në vijim të sa më sipër, Bashkia Durrës, me shkresën nr. 1684/1 Prot., datë 03.02.2020, të protokolluar në IN me nr. 309/2 Prot., datë 05.02.2020 (***nënshkruar nga person i deleguar, i panjohur, në emër të ZhV, zëvendëskryetar***) konfirmon se në shkresën nr. 1684, datë 31.01.2020 drejtuar IN-së, mungojnë edhe dy institucione arsimore, duke i kërkuar IN që të kryejë Akt Ekspertizat e thelluara edhe për këto 2 objekte arsimore të tjera, konkretisht:

3. shkolla e mesme sportive ëBernardina Qerraxhijaö; dhe
4. konvikti i shkollës së mesme profesionale ëBeqir Çelaö, në katin e parë të së cilit ndodhet menca dhe kuzhina e tij.

Pra deri më datë 03.02.2020, nga 11 shkolla që i takojnë Bashkisë Durrës dhe që janë në listën e VKM nr. 32, datë 02.07.2020, vëmë re se, fillimisht janë kërkuar nga kjo Bashki kryerja e aktekspertizave të thelluara vetëm për 4 prej 11 objekteve (edhe këto të iniciuara nga vetë Bashkia Durrës).

Rreth tre muaj pas shkresës së parë, me shkresënr. 111/9, datë **30.04.2020**, të protokolluar në IN me nr. 998 Prot., datë 30.04.2020, Bashkia Durrës (***nënshkruar nga ES, zëvendëskryetar***) i është drejtuar Komitetit Shtetëror për Rindërtim (KSHR), për dijeni Ministrin të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Ndërtimit, duke i kërkuar që të përfshihen në listën për rindërtim apo rikonstruksion ndër të tjera edhe objektet:

5. Kopshti Bizë - rindërtim
6. Cerdhja nr. 2 - rikonstruksion
7. Cerdhja nr. 3 - rikonstruksion
8. Shkolla 9 vjecare Eftali Koci - rindërtim
9. Gjumnazi Gjargj Kastrioti - rindërtim
10. Gjumnazi Naim Frashëri - rindërtim
11. Gjumnazi Olsi Lasku - rindërtim

Për sa më sipër, me urdhrat nr. 309/1, datë 04.02.2020 dhe nr. P309/1 Prot., datë 07.05.2020, të titullarit të IN, janë ngritur grupet e punës, për kryerjen e akt-ekspertizave dhe objekteve arsimore sipas listës së vënë në dispozicion nga Bashkia Durrës.

Nga gjithë sa më sipër konkludojmë se, Bashkia Durrës ka iniciuar procesin për akt ekspertiza të thelluara, **në kundërshtim** me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht:

- *Së pari* në kundërshtim me pikën 1, të VKM-në nr. 26, datë 15.01.2020, *ëPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraö*, pasi Bashkia ka kërkuar ekspertiza të thelluara edhe pse në asnjë prej akt konstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit, nuk është kërkuar ekspertizë e thelluar.

- *Së dyti*, duke ju drejtuar Instituti i Ndërtimit dhe jo personave fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare dhe të pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore, ka vepruar në kundërshtim me nenin 4, të paragrafit 14, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, *Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreö*, si dhe në kushte të konfliktit të interesit pasi, sipas përcaktimit në VKM-në nr. 26, datë 15.01.2020 *ëPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraö*, pika 2, IN është parashikuar të kryejë oponencat teknike të këtyre akt ekspertizave të thelluara, si dhe të jap opinionin e tij, i cili mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore

ose autoritetet përgjegjëse. Fakti që IN ka kryer ekspertizat teknike dhe njëkohësisht edhe oponentin e tyre, e vendos këtë institucion në kushtet e konfliktit të interesit, pasi nuk mund të bëjë oponentin e vetes.

-Së treti, inxhinierët pjesë e ekipeve të punës të IN-së, nuk posedonin licencën 3.d (*Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike*) sikundër edhe është kërkuar në òKërkesën për bashkëpunim që vetë IN ka publikuar<sup>4</sup> në faqen zyrtare. Në fakt, vetëm posedimi i kësaj pike të licensës, duke ju referuar kërkesave të VKM nr. 26, datë 15.01.2020 *“Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”*, lejon realizimin e të gjithë procedurave inxhinierike sipas kriteve që dikton kuadri ligjor i sipërcituar. (*Trajtuar në faqet nr 58-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

### 8.1 Rekomandimi:

Në kushtet kur, inicimi, nga Bashkia Durrës, i kërkesës për hartimin e akt-ekspertizave është kryer **në kundërshtim** me kuadrin ligjor në fuqi, rekomandojmë që gjithë procesi të ri-analizohet përsëri, duke filluar nga verifikimet dhe analizat fillestare sipas aktkonstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të IN-së, apo grupeve të Inspektimit, për të konkluduar në bazë të këtyre të fundit **dhe jo ndryshe**, nëse kërkohet ose jo rivlerësim më i thelluar.

Gjithashtu, rekomandojmë, që në rastet kur do të konkludohet nevoja për kryerjen e analizave të thelluara (nëse do të ketë), Bashkia Durrës të iniciojë procedurën mbi kryerjen edhe njëherë të akt ekspertizave për të11 objektet ó subjekt i këtij auditimi, nga persona fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare dhe të pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore, për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, duke vendosur, ndër të tjera, si kriter pajisjen me licencë të kategorisë 3.d (*Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike*).

**Menjëherë**

### 9. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se, akt ekspertizat (AE) janë hartuar në trajtë shablloni, duke bërë më shumë historikun e tërmeteve në Shqipëri, sesa trajtuar problemet e objekteve, për inspektimin e detajuar të të cilave nuk ka asnjë evidencë që të provojë se është verifikuar hekuri i kolonave apo gjendja e mureve poshtë suvasë, duke pasur parasysh edhe se këto lloj ekzaminimesh nuk janë konstatuar nga inspektimi në terren i grupit të audituesve të KLSH-së.

Në asnjë prej rasteve objekt i këtij auditimi, **aktekspertiza e thelluar nuk përmbante, (i) masat për riparimet** dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si **dhe (ii) vlerën financiare për këto ndërhyrje**, në kundërshtim me sa parashikon nenit 34, paragrafi 2 i Aktit Normativ nr. 9, datë 16,12,2019 -Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore Sipas aktit të sipërpërmendur, vetëm nëse sipas studimit të thelluar të mbështetur dhe nga oponenti e IN, ndërhyrjet për riparimin e strukturës do të kushtojnë më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës, atëherë njësisia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos për shembjen e detyruar të objektit, dhe jo ndryshe. Në këto kushte, gjykojmë se, veçanërisht mungesa e vlerës financiare (pra kostos së riparimit dhe kostos së rindërtimit) ka bërë që vendim-marrja për rindërtim ose rikonstrukcion të këtyre objekteve, të jetë e pabazë, duke mbartur riskun që njëkohësisht të jetë edhe e gabuar. (*Trajtuar në faqet nr 58-84,, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

<sup>4</sup>linku referues:

<http://www.institutindertimit.al/sites/default/files/K%C3%ABrkes%C3%AB%20p%C3%ABr%20Bashk%C3%ABp%20unim%C3%ABr%20kryerjen%20e%20Akt-Ekspertizave..pdf>



### 9.1 Rekomandimi:

Nisur nga sa më sipër, me qëllim shmangien e riskut që aktet e ekspertizës tashmë të kryera, të mos shprehin saktë dhe drejtë situatën, si dhe në funksion të një vendimmarrjeje të shëndoshë dhe të bazuar, rekomandojmë marrjen e masave nga ana e Bashkisë Durrës, që menjëherëpas **ri-fillimit** të një procesi të drejtë dhe të ligjshëm për **identifikimin** e atyre objekteve që kanë nevojë për akt ekspertizë të thelluara, **të nis procesin e prokurimit për kontraktimin e ekspertëve** duke treguar kujdesin maksimal që aktet e ekspertizës të përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar si, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës, vlerën financiare për këto ndërhyrje, etj.

Vetëm pas kësaj, këto akte duhet t'vihen në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës me qëllim dhënien e opinionit të tij, i cili ky i fundit mbizotëron mbi akt ekspertizat e thelluara dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjës.

Në përfundim, vetëm nëse sipas studimit të thelluar (akt ekspertizës) të mbështetur dhe nga oponenca e IN, ndërhyrjet për riparimin e strukturës do të rezultojnë të kushtueshme më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës do të duhet të vendos shembjen e detyruar të objektit, dhe jo ndryshe.

**Menjëherë**

### 10. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se, dokumentet e titulluara *“Oponenca Teknike”, të cilat janë kryer vetëm për objektet e cilësuar për rindërtim (nga të cilat vetëm oponencat për shkollën dhe konviktin e shkollës “Bernardina Qerraxhija” janë protokolluar), bëjnë një përshkrim dhe përsëritje të akt ekspertizave, duke mos paraqitur asnjë të dhënë dhe duke dalë jashtë objektivave dhe qëllimit të hartimit të një oponente teknike. Rezultoi se, oponencat teknike janë hartuar pa studim, pa ekspertizë, pa analizë dhe vlerësim financiar, si dhe pa ndonjë aktmarrëveshje me Bashkinë Durrës, në kundërshtim me VKM-në nr. 1055, datë 22.12.2010 *“Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”*. Sipas kësaj VKM-je, *“Oponenca i bëhet projektit për të gjitha veprat e ndërtimit, të cilat nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike. Pas miratimit të kërkesës, palët lidhin marrëveshje ndërmjet tyre, kushtet e së cilës miratohen nga ministri i Punëve Publike dhe Transportit (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës).”* Për më tepër, në faqen zyrtare të IN, në skedarin *“Drejtoria/Drejtoria e Rregullave Teknike dhe Oponencave”, në pjesën e referimit të bazës ligjore për sektorin e oponencave, nga IN I bëhet referencë në mënyrë të gabuar një VKM-je që nuk ekziston, konkretisht VKM nr. 243 dt. 12/06/2019 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”*<sup>5</sup>.(Trajtuar në faqet nr 58-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

#### 10.1 Rekomandimi:

Bashkia Durrës, së bashku me IN-në, me qëllim kryerjen e oponencave, të lidhin marrëveshje ndërmjet tyre, kushtet e së cilës të miratohen nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

**Menjëherë**

### **A.3 Mbi zbatimin e procedurave ligjore të procedurës së prokurimit dhe marrjes në dorëzim të projektit me objekt “Rikonstruksioni dhe shtesë anësore dhe e palestrës së re në shkollën 9 vjecare “14 Nëntori”, Durrës”, rezultoi sa më poshtë vijon:**

<sup>5</sup>linku referues: <http://www.institutindertimit.al/sq/content/drejtoria-e-rregullave-teknike-dhe-oponencave>). VKM-ja nr. 243 është e datës 19.04.2019 (FZ 64) dhe nuk ka asnjë lidhje me ndërtimin.

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit të projektit me objekt òRikonstruksioni dhe shtesë anësore dhe e palestrës së re në shkollën 9 vjecare ò14 Nëntoriò rezultoi se:

- Dosjet e dokumentave të tenderit janë të inventarizuara por numërtimi nuk është i rregullt.
- Për përgatitjen e ST është mbajtur PV pa datë dhe numër protokolli.
- Për hartimin e dokumentave të tenderit është mbajtur PV pa datë dhe pa numër protokolli.
- Nga Njësia e Prokurimit janë hartuar dy shtojca, pa numër protokolli, përkatësisht në datat 11 dhe 12.07.2017.
- Hapja e ofertave është bërë në datën 24.07.2017, për të cilën është mbajtur PV pa numër protokolli.
- Procesverbali për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur është mbajtur në datën 28.07.2017, pa numër protokolli.
- Njoftimi i Klasifikimit të ofertuesve është bërë në datën 28.07.2017, pa numër protokolli.
- Në datën 01.08.2017 është mbajtur PV pa numër protokolli për vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave.
- Raporti përmbledhës është hartuar në datën 09.08.2017, pa numër protokolli.

Sa më sipër në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 òPër arkivatò, dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë (Trajtuar në faqet nr 13-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**11.1 Rekomandimi:** Në të gjitha rastet, në të ardhmen, të eliminohen praktika të tilla që bien në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 òPër arkivatò, dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. Nga Bashkia Durrës të merren masa që çdo dokument i administruar nga ky institucion, të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Në vazhdim, Bashkia Durrës të marrë masa për kryerjen e trainimeve të vazhdueshme të punonjësve, në lidhje me njohjen e rregullave që lidhen me levizjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit.

**Në vijimësi**

**11.2 Rekomandimi** Nga Bashkia Durrës të merren masa për të ngritur një grup pune me qëllim analizimin e pasojave që kanë sjellë veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, sa i takon moszbatimit të kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator për arkivat, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt òRikonstruksioni dhe shtesë anësore dhe e palestrës së re në shkollën 9 vjecare ò14 Nëntoriò rezultoi se:

- Në pikën 6b të ST, në titullin e kapitullit përcaktohet suvatim i jashtëm grafiato, ndërkohë që në shpjegime dhe në preventiv nuk përmendet suvatimi me grafiato.
- Në pikën 6c të ST, përcaktohet veshje e fasadës me pllakë terrakota, ndërkohë që në preventiv nuk është parashikuar ky zë punimesh.
- Në pikën 7a të ST, përcaktohet që suvatimi do të lëmohet me letër zmerile, do të stukohet dhe do të lyhet me astar, ndërkohë që në preventiv nuk janë parashikuar këto punime.
- Në pikën 8c të ST, përcaktohet që dyert e brendshme të klasave duhet të jenë me kasë alumini, me pllakë antigoditjes, me 10% xham, etj., ndërsa në pikën XIII të preventivit parashikohet që dyert të jenë zemër dërrase, kasë dërrase, ½ xham.

*-Në pikën 8d të ST, përcaktohet që dritaret duhet të jenë plastike, me dy dhoma ajri, etj., ndërsa në pikën XIII të preventivit parashikohet që dritaret të jenë d/alumin plastike me dopio xham. Nga auditimi rezultoi se: kërkesa d/alumin plastike është e gabuar, pasi një dritare nuk mund të jetë njëherësh edhe alumin edhe plastikë dhe krahas kësaj, kërkohet të jetë me dopio xham, pra me një dhomë ajri, ndryshe nga ST; gjithashtu në ST janë parashikuar punime për sisteme interneti, telefonie, gjenerator energjie, etj, të cilat nuk janë parashikuar në preventiva; në ST nuk ka asnjë kërkesë për ashensorin, i cili është parashikuar në preventiva dhe ka mjaft hollësi dhe kërkesa për punime dhe materiale të cilat nuk janë parashikuar në preventiva dhe nuk kanë lidhje me këtë objekt. Nisur nga sa më sipër, ST bien ndesh me kërkesat e nenit 23, të LPP *Specifikimet teknike* pika 1 dhe pika 3; si dhe me VKM-në 914, neni 26, *Kontratat për punë publike*, pika 3.*

Në vijim, nga Njësia e Prokurimit janë hartuar dy shtojca, pa numër protokolli, përkatësisht në datat 11 dhe 12.07.2017, nëpërmjet së cilave është hequr kriteri i vendosur në pikën 2.3, Kapaciteti teknik, germa h: *ökategoria licenca për punimet arkeologjike, A1. Survey dhe sondazh arkeologjik dhe A2. Gërmim arkeologjik* dhe germa i: *öStafi teknik i shoqërisë për punimet arkeologjike të ketë në përbërje: Drejtues teknik me licensepergërmim arkeologjik – 1 (një), Arkeolog – 1 (një), Punëtor të thjeshtë – 2 (dy)*. Data e zhvillimit të tenderit është lënë 24.07.2017.

Kriteret për kualifikim të hartuara për këtë prokurim nuk janë argumentuar për çdo rast, por vetëm janë listuar në PV pa numër dhe datë të hartuar nga Grupi i Specifikimeve Teknike, i përcjellë te NjP me shkresën nr. extraProt., datë 06.06.2017. Këto kritere nuk janë në përputhje me VKM-në 914 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*, neni 26, *Kontratat për punë publike*, pika 5 dhe neni 61, *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*, pika 2, paragrafi 2.

Për të vërtetuar punët e ngjashme, nuk janë kërkuar vërtetime, të cilat duhet të shoqëroheshin me dokumentet e sipërpërmendura, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, neni 26, *Kontratat për punë publike*, pika 6, paragrafi i fundit.

Kërkesa për mjek është e tepërt, nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 *Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*, pika 1;

Kërkesa për certifikatat: *öISO 9001 - Për cilësinë e sistemeve të menaxhimit*, *öISO 14001- Për sistemet e menaxhimit të mjedisit*, *öOHSAS 18001- Për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë profesionale* të OE nuk janë në përputhje me LPP si më sipër, pasi nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe janë diskriminuese, ndërsa certifikata *öISO 9001 - Për cilësinë e sistemeve të menaxhimit* që kërkohet për furnitorët nuk vërteton cilësinë e mallrave. Nga ana tjetër, kërkesa për certifikatë ISO 9001 të prodhuesve për cilësinë e disa produkteve, jo vetëm që është e tepërt, preferenciale dhe dokumenti që ka përcaktuar fituesin në këtë garë, por nuk mund të vërtetohet as cilësinë e produkteve dhe as ndonjë element tjetër që ka të bëjë me cilësinë e produkteve. Përkundrazi, AK duhet të kishte kërkuar certifikata konformiteti dhe përputhje me standardet e BE-së apo të tjera të zbatueshme, sipas rastit.

Përveç automjeteve dhe pajisjeve të kërkuara në DST, AK detyrimisht duhet të ishte kërkuar kontratë furnizimi apo fabrikë prodhimi për betonet, konstruksionet metalike, armaturat, etj., pa të cilat nuk mund të kryhen punimet e parashikuara.

Gjithë sa më sipër, jo vetëm nuk është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, por gjithashtu ka ndikim në uljen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; nuk siguron mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; nuk nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; nuk siguron një trajtim të barabartë dhe

jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; nuk siguron integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. (Trajtuar në faqet nr13-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

### **12.1 Rekomandimi:**

Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të përdorë dokumentet standard sipas formatit të përgatitur nga APP-ja, pa i modifikuar në asnjë rast apo element ato, qoftë pa dashje apo me qëllim dhe në çdo rast, Njësia e Prokurimit ose Grupi i ngritur posaçërisht, në hartimin e miratimin e kriterëve të kërkesave për kualifikim pjesë e DST, të argumentojë me hollësi çdo kriter të kërkesave kualifikuese, mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave sipas manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, licencave, etj, duke i pasqyruar në procesverbalin përkatës.

**Në vijimësi**

### **13. Gjetje nga auditimi:**

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të procedurës së prokurimit me objekt ÷Rikonstruksioni dhe shtesë anësore dhe e palestrës së re në shkollën 9 vjecare ÷14 Nëntori rezultoi se, BOE fitues nuk ka paraqitur vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria. OE të tjerë nuk i kanë paraqitur, në kundërshtim me LPP, neni 45, ÷Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë pika 3, germa a). Pavarësisht se OE kanë deklaruar se nuk janë dënuar për shkelje penale me vendim të formës së prerë nga gjykata, dhe se sipas kërkesës së APP-së, këto vërtetime nuk kërkohet të ngarkohen në sistemin e prokurimit elektronik, këto vërtetime duhet të jenë pjesë e dosjes së prokurimit;

Nga verifikimi i pagesave nëpërmjet thesarit, u konstatua se gjatë vitit 2018 OE RN ka marrë nga Bashkia Durrës vlerën prej 121,847,404 lekë, ndërsa gjatë vitit 2019 vlerën prej 117,875,337 lekë. Gjatë këtyre dy viteve, OE RN ka kontraktuar vetëm me Bashkinë Durrës. Në vitin 2017, për të njëjtën periudhë gjatë së cilës janë zhvilluar punimet për rikonstruksionin dhe shtesat anësore të shkollës 14 nëntori, ky OE ka lidhur edhe dy kontrata të tjera me bashkinë Durrës, konkretisht kontratën nr. 20337 datë 01.12.2017 ÷Rikonstruksioni i kopshtit "Sotir Koka"÷ dhe kontratën nr. 21577 datë 26.12.2017, ÷Rikonstruksion i godinave shkollorë. Për këto dy objekte të tjera, nga ky OE është deklaruar se do të përdoren të njëjtat makineri dhe fuqi punëtore si në objektin që po auditohet.

Këto veprime/mosveprime bien ndesh me LPP, neni 46 ÷Kualifikimi i ofertuesve, pika b) ÷aftësia teknike÷ dhe VKM-në 914, Neni 26 ÷Kontratat për punë publike, pika 8.

Në bilancet e BOE fitues nuk figurojnë në inventar të gjitha mjetet të cilat pretendohet se disponohen. Pavarësisht se BOE ka paraqitur fatura apo deklarata zhdoganimit, dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton disponimin e tyre, nuk është i plotë dhe rrjedhimisht nuk mund dhe nuk duhet të merret në konsideratë. Pa paragjykuar faktin që OE i ka blerë në vite ato makineri/pajisje sipas dokumenteve të paraqitura, ai aktualisht nuk i disponon makineritë/pajisjet e kërkuara, pasi nuk i ka në inventaret bashkëlidhur bilancit të paraqitur. Sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, kreu II ÷Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve÷ dhe SKK 5÷Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale, pika 7 dhe 8, të gjitha aktivet që posedon një njësi ekonomike, detyrimisht duhet të regjistrohen dhe inventarizohen në llogaritë përkatëse kontabël që në momentin e përfutimit të tyre nga blerja apo prodhimi.

Pra, nqs një aktiv i njësisë ekonomike nuk figuron në inventaret e saj kontabël, ai nuk ekziston juridikisht.

Për dy ekskavatorë dhe një fadromë në pronësi të OE RN, dokumentacioni paraqitur nuk është në përputhje me DST, si dhe është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 *“Kodi rruigor i Republikës së Shqipërisë”, neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”, pika 4.*

Për sa më sipër, çdo lloj makinerie teknologjike duhet të pajiset me targat njohëse të cilat kanë formatin: XXMTXX (dy karakteret e para janë shkronja, dy të mesit kanë kuptimin Makineri Teknologjike dhe dy të fundit janë numra).

- Për autovinçin e paraqitur nga OE R shpk, të marrë me qera nga Jovan Ikonomi, konstatohet se në dokumentacionin shoqërues ky mjet është për ÷përdorim vetjakë, rrjedhimisht nuk mund të jepët apo merret me qera;

- Për automjetet e paraqitura nga OE R shpk, të marra me qera nga shoqëria ÷Cö, nga auditimi u konstatua se në lejet e qarkullimit të automjeteve cilësohet se këto mjete janë për ÷përdorim vetjakë ose për ÷përdorim nga III Fö, ndërsa lejet e lëshuara nga pushteti vendor, për të gjithë mjetet e treguar janë për ÷transport mallrash brenda vendit për llogari të vetë. Makineritë, si eskavator dhe fadroma nuk janë të pajisura me targa dhe leje qarkullimi.

- Automjetet e paraqitur nga OE V sipas kërkesave në DST janë:

- Autobetoniere 1 copë;
- Kamion 7.5-18 ton, 1 copë;
- Autobot 7.5-18 ton, 1 copë;
- Autovinç për të cilin nuk vërtetohet që krahu është 15-20 m, sipas DST;
- Eskavator me goma/kovë, 2 copë;
- Fadromë me goma dhe kovë;
- Kamiona mbi 18 ton, 1 copë;
- Kamionçinë deri në 3,5 ton, 1 copë.

Sa më sipër, konstatohet se BOE nuk i disponon ligjërisht të gjitha mjetet e kërkuara nga DST, megjithëse ka deklaruar se i plotëson kriteret e kualifikimit teknik e profesional, rrjedhimisht duke rënë në kushtet e deklaramit të rremë.

Përveç deklaramit të rremë në lidhje me plotësimin e kriterëve teknike dhe profesionale, he fuqinë punëtore, përdorimi i burime teknike dhe njërezore të pamjaftueshme ka ndikuar edhe në cilësinë e kryerjes së punimeve sipas kontratave në fjalë.

Çertifikatat ISO të OE R Ndërtim dhe të OE V E, janë fotokopje me ngjyra të panoterizuara. Çertifikatat e OE R Ndërtim nuk kanë vulën e institucionit që i ka lëshuar, ndërsa nga OE V E, vetëm çertifikata e menaxhimit të sistemit të mjedisit është e pavulosur. *(Trajtuar në faqet nr13-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**13.1 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin dhe skualifikimin e OE konkures, për qëndrimin jokorrekt të KVO-së në vlerësimin e ofertave konkures në përgjithësi dhe veçanërisht ofertave të cilat kanë parregullsi të njëjta ose të ngjashme, duke mos shkaktuar diskriminim dhe vlerësim me dy standarde.

**Menjëherë**

**13.2 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, për të gjitha rastet në vazhdim, të marrëmasa, të cilat:

-eliminonjëndjekjen e praktikave që nuk marrin në konsideratë kërkimin e informacioneve shtesë, për të verifikuar vërtetësinë e deklaramit të OE në lidhje me kontratat e tjera që mund të kenë lidhur dhe përdorimin e të njëjtave burime, njerëzore dhe teknike, gjithmonë të prirur

për të realizuar në afat dhe me cilësi punimet apo shërbimet, si dhe për të kualifikuar ofertën ekonomike më të favorshme, duke u nisur nga çmimi më i ulët;

- eliminojnëndjekjen e praktikave që shkaktojnë diskriminim dhe vlerësim me dy standarde, veçanërisht për oferta të cilat kanë parregullsi të njëjta ose të ngjashme.

Gjithashtu të merren masa për ngritjen e kapaciteteve, duke identifikuar dhe plotësuar nevojat për trainime në fushën e prokurimeve publike me qëllim kryerjen e procedurave konform kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

**Në vijimësi**

**13.3 Rekomandimi:** Gjatë kontrollit dhe vlerësimit të ofertave, nga NJP të merret në konsideratë që OE fitues të disponojë në dosjen fizike vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria, për gjendjen gjyqësore, për të vërtetuar saktësinë e deklarimit të OE. Për makineritë teknologjike vetëlëvizëse në pronësi apo me qera, në të gjitha rastet nga KVO të kërkohet dokumentacioni i duhur për regjistrimin e tyre, përfshirë lejen e qarkullimit, targimin, siguracionin etj., ndërsa për pajisjet e tjera të kërkohet regjistrimi i tyre në inventaret kontabël, bashkëlidhur bilancit.

**Në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE V E, u konstatua se ka paraqitur vërtetim për pagesën e taksave vendore në bashkinë Shijak, ku ka selinë qendrore, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkia Durrës dhe nga bashkitë e tjera ku ka ushtruar veprimtari. OE R Ndërtim ka paraqitur një vërtetim nga sigurimet shoqërore për efekt të prokurimit *ōRikonstrukcion rruga e pulave Xhafzotajō*. Nga ana e KVO-së nuk është kërkuar asnjë dokument shtesë për t'u siguruar që këto OE nuk kanë detyrime të tjera vendore, si dhe që nuk kanë fituar asnjë nga prokurimet për të cilat kanë marrë vërtetimet e mësipërme, ku mund që të kenë paraqitur të njëjtat makineri/pajisje dhe personel teknik e puntori. Gjatë viteve për të cilat kanë paraqitur bilancet, këto OE kanë pasur kontrata në bashki dhe institucione të tjera, për të cilat, sipas ekstrakteve historike të paraqitura nuk kanë hapur adresa sekondare për zhvillim veprimtarie biznesi, në kundërshtim me ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 *ōPër qendrën kombëtare të regjistrimitō*, i ndryshuar, duke shkaktuar edhe shmangie të pagesave të detyrimeve tatimore vendore. (*Trajtuar në faqet nr13-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

#### **14.1 Rekomandimi:**

Nga Bashkia Durrës, të merren masa për të verifikuar nëpërmjet sistemit të thesarit apo forma të tjera, nëse OE të cilët konkurojnë në procedurat e prokurimit të shpallura prej saj, kanë shlyer të gjitha detyrimet vendore, kudo që të kenë ushtruar veprimtari, si dhe nëse kanë regjistruar të gjitha adresat e tyre sekondare

#### **14.2 Rekomandimi:**

Nga Bashkia Durrës, të merren masa për të nxjerrë detyrimet, për të kontabilizuar si debitorë dhe për të kërkuar pagesat e taksave dhe tarifave vendore, nga të gjithë OE që kanë ushtruar aktivitet në territorin e saj duke kryer punë apo shërbime publike, sipas afateve përkatëse të ushtrimit të aktivitetit, duke përdorur të gjitha mënyrat ligjore, përfshirë edhe masat shtrenguese dhe kërkesën në rrugë gjyqësore, deri në shterimin e e të gjitha mundësive.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **15. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i vendimeve për skualifikimin dhe kualifikimin e OE pjesëmarrës, raportit përfundimtar të KVO-së dhe njoftimit për fituesin e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt òRikonstruksioni dhe shtesë anësore dhe e palestrës së re në shkollën 9 vjecare ò14 Nëntoriò, u konstatua se BOE i kualifikuar dhe i shpallur fitues është i dyti në renditje sipas vlerës së ofertuar (i pari: BOE E 2000 + P në vlerën 65,049,299 lekë. Duke pasur parasysh se diferenca nga BOE me vlerën më të ulët është e vogël (677,904 lekë ose 0.75% e vlerës së fondit limit), si dhe duke marrë të mirëqënë vlerësimin e KVO-së për skualifikimin e OE të tjerë, (nga auditimi i dokumentacionit të të cilave u konstatuan parregullsi të tjera, të cilat nuk janë trajtuar nga KVO-ja), u auditua hollësisht dokumentacioni bashkëlidhur ofertës fituese, kryesisht për kriteret të cilat nga KVO janë konsideruar si të paplotësuara nga OE të tjerë. Nga auditimi i kontratave të OE me prodhuesit e produkteve të listuara në DST dhe për pajisjen e këtyre prodhuesve me Çertifikatën ISO 9001, për mangësitë në posedimin e të cilave janë skualifikuar OE të tjerë, rezultoi se:

**1.** Për parketin laminat, nuk vërtetohet lidhja e zyrtarizuar ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit, pasi nuk është paraqitur kontratë apo aktmarrëveshje noteriale e rregullt ndërmjet shitësit (Delta) me të cilin ka kontraktuar OE R Ndërtim dhe prodhuesit (T). Krahas sa më sipër, çertifikata ISO e prodhuesit ka përfunduar në datën 26.06.2017, datë në të cilën ky prodhues duhet të ishte riçertifikuar.

**2.** Për ashensorin, nuk vërtetohet lidhja e zyrtarizuar ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit, pasi nuk është paraqitur kontratë apo aktmarrëveshje noteriale e rregullt ndërmjet shitësit (OtisElevators) me të cilin ka kontraktuar OE R Ndërtim dhe prodhuesit (M LTD). Krahas sa më sipër, çertifikata ISO e prodhuesit ka përfunduar në datën 03.03.2017, datë në të cilën ky prodhues duhet të ishte riçertifikuar.

**3.** Për kaldajën, nuk vërtetohet lidhja e zyrtarizuar ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit, pasi nuk është paraqitur kontratë apo aktmarrëveshje noteriale e rregullt ndërmjet shitësit (HS shpk) me të cilin ka kontraktuar OE R Ndërtim dhe prodhuesit (Th). Krahas sa më sipër, çertifikata ISO e prodhuesit është lëshuar për shoqërinë òS.C. TRST SRLò me adresë në Rumani, ndërsa deklarata që i jep të drejtën shitësit është nënshkruar nga shoqëria òTBMò me adresë në Greqi. Gjithashtu, përmasat e kësaj kaldaje janë rreth dyfishi i përmasave të kërkuara në DST dhe në të dhënat teknike të paraqitura nuk vërtetohet plotësimi i kriterit për lidhjet òDN50ò dhe për daljen e oxhakut òøe200 mmò.

**4.** Për pompën e qarkullimit, nuk vërtetohet lidhja e zyrtarizuar ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit, pasi nuk është paraqitur kontratë apo aktmarrëveshje noteriale e rregullt ndërmjet prodhuesit ( SE) dhe OE R Ndërtim. Autorizimi i paraqitur është vulosur për llogari të shoqërisë ò Aò, për të cilën, pas verifikimit të ekstraktit historik në bazën e të dhënave online të QKB-së, u konstatua se në datën 18.04.2017 ka filluar procedurat e likuidimit. Gjithashtu, Fusha e veprimtarisë të kësaj shoqërie, ka qenë òHulumtimi i tregut, ruajtja e kontakteve afariste, kryerja e punevepergatitore, etjò. Pra, në asnjë rast kjo shoqëri nuk mund të lëshonte autorizime apo premtime furnizimi të cilat nuk kanë tagër ligjore dhe janë mashtruese. Krahas sa më sipër, çertifikata ISO e prodhuesit është lëshuar për shoqërinë ò SEò me adresë në Gjermani, ndërsa autorizimi që i jep të drejtën shitësit është nënshkruar nga shoqëria ò Aò me adresë në Shqipëri, e cila pavarësisht se ka qenë në fazë likuidimi, përveç një pjesë të emrit, nuk vërteton lidhjen me prodhuesin.

**5.** Për pemët, nuk vërtetohet lidhja e zyrtarizuar ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit, pasi nuk është paraqitur kontratë apo aktmarrëveshje noteriale e rregullt ndërmjet shitësit (K shpk) me të cilin ka kontraktuar OE R Ndërtim dhe prodhuesit (P VV SL). Marrëveshja është e panënshkruar dhe e pavulosur nga K shpk. Krahas sa më sipër, çertifikata ISO e prodhuesit ka përfunduar në datën 27.07.2017.

**6.** Për ndriçuesat, nuk vërtetohet lidhja e zyrtarizuar ndërmjet ofertuesit dhe prodhuesit, pasi nuk është paraqitur kontratë apo aktmarrëveshje noteriale e rregullt ndërmjet shitësit (BB) me

të cilin ka kontraktuar OE R Ndërtim dhe prodhuesit (GHOC, LTD, Kinë) apo eksportuesit (P, Kinë). Krahas sa më sipër, asnjë nga ndriçuesat e paraqitur nuk përputhet me ST, pasi, pa u ndalur me të dhënat e tjera teknike, nga OE kërkohen ndriçuesat LED, me të dhëna:

- a) 2x17 , 120x20 cm, 3900K, 3000lm, IP40;
- b) 12 , 68x135 mm, 4200K, 910lm, 50,000 orë; dhe
- c) 2x36 , 125 cm, 3900K, 4000,

ndërsa nga OE janë paraqitur prospekte për ndriçuesat me fuqi

- a) 40 / 1200x86x70mm / 4500K / 3600lm / IP65;
- b) 18 , 1200 mm, 28 mm, 3000/4000/6000K, 1800lm; dhe
- c) 9 , 145x79mm, 3000/6400K, 810lm.

Në lidhje me jetëgjatësinë e kërkuar 50,000 orë, kjo e dhënë disponohet vetëm për ndriçuesin 40 , është 20,000 orë dhe nuk është përpikthyer.

Çertifikata për shpërndarësin e autorizuar është dhënë nga shoqëria ÷VE LTD me adresë në Bullgari, për të cilën nuk dihet nëse ka apo jo të drejta përfaqësimi dhe delegimi të kompetencave. Kjo certifikatë është pa vulë dhe nënshkrim të lëshuesit. Çertifikata e partneritetit, e cila i drejtohet shoqërisë VE LTD, nuk vërteton të drejtat e kësaj shoqërie mbi produktet në fjalë, por që partner i autorizuar për produktet e markave Vito, Vitone, etj., është shoqëria ÷Pö.

Në asnjë nga rastet e përmendura më sipër në lidhje me produktet, dokumentacioni i prodhuesit, përfshirë certifikatat ISO, manualët, prospektet, autorizimet, etj., (bashkëlidhur kontratës së furnizimit) nuk është i noterizuar *÷Njësia me origjinalinö* por ka vetëm përkthimet dhe vulat e noterizimit për nënshkrimin e përkthyeses, ku në disa raste përkthimi është jo i plotë. Këto veprime/mosveprime janë në kundërshtim me DST, shtojca 10, paragrafi i fundit.

Sa më sipër, duke pasur parasysh se të gjithë OE të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë, janë skualifikuar për parregullsi në këtë lloj dokumentacioni specifik (sipas tabelës më sipër) dhe për BOE RN+V E, ky dokumentacion është konsideruar i rregullt duke mos qenë i tillë, përbën vendimmarrje me dy standarde nga KVO, duke shkelur barazinë në tendera.

Si konkluzion, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE RN+V E dhe nuk duhet t'aj kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin, të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret për të rritur numrin e pjesëmarrësve. Moskryerja e anulimit të procedurës është në kundërshtim me kërkesat e LPP, neni 24 *÷Anulimi i një procedure prokurimiö*, pika 1, neni 46 *÷Kualifikimi i ofertuesveö*, pika 1 dhe neni 53, *÷Shqyrtimi i ofertaveö* pika 3. (*Trajtuar në faqet nr13-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

### **15.1 Rekomandimi:**

Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa për ngritjen e kapaciteteve, duke identifikuar dhe plotësuar nevojat për trainime në fushën e prokurimeve publike me qëllim kryerjen e procedurave konform kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

**Në vijimësi**

### **15.2 Rekomandimi:**

Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që të ngrëjë grup pune, me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësi për qëndrimin jokorrekt dhe me dy standarde të KVO-së, në vlerësimin e ofertave konkurruese, të konstatuar në kualifikimin dhe skualifikimin e OE konkurues, duke shkaktuar kështu diskriminim, pabarazi dhe mungesë transparence.

**Menjëherë**

### **15.3 Rekomandimi:**

Nga KVO, të merren masa që, në të gjitha rastet të pranohen si kualifikuese vetëm dokumente origjinale ose të noterizuara, ku për noterizimin të kërkohet ÷vërtetimi i njësise me origjinalinö dhe për përkthimin të verifikohet nëse përkthyesi është i njohur si përkthyes



zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, si dhe në asnjë rast, të mos pranohen si origjinale dokumentet të cilat kanë vulën e noterisë për qëllime të tjera, si p.sh. ÷vërtetim përkthimi, etj.

## Menjëherë dhe në vijimësi

### 16. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i faturave dhe situacioneve të paraqitura për objektin ÷Rikonstruksioni dhe shtesë anësore dhe e palestrës së re në shkollën 9 vjecare ÷14 Nëntori, u konstatua se faturat janë paraqitur me vonesë, duke përbërë shkelje të afateve kontraktuale, krijim të detyrimeve të prapambetura, probleme me vënien në përdorim të objekteve të ndërtuara dhe mospagim në kohë të TVSH-së. Duke pasur parasysh që kontrata është lidhur në datën 21.09.2017, me afat 170 ditë dhe është shtyrë për një afat total prej 230 ditësh, si rregull dhe për aq kohë sa nuk ka pasur ngjarje të forcës madhore, etj, punimet duhet të ishin përfunduar dhe fatura e fundit duhet të ishte dorëzuar jo më vonë se në datën 08.05.2018. Nga verifikimi i faturave të paraqitura, u konstatua se nga OE R Ndërtim sh.p.k. janë paraqitur gjithsej 7 fatura, nga të cilat fatura e fundit në vlerën 9,508,083 lekë, është paraqitur 134 ditë pas afatit të përfundimit të kontratës dhe marrjes në dorëzim të punimeve. Në datën 24.09.2018, ka dalë Urdhër-Shpenzimi nr. 850, për mbajtjen e garancisë së punimeve në shumën 5% të vlerës së kontratës ose 3,943,556 lekë. Kjo vlerë monetare është mbajtur nga fatura e fundit, bashkëlidhur situacionit përfundimtar.

Fatura nr. 20, datë 20.09.2018 dhe situacioni përfundimtar janë paraqitur në shkelje të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, neni 51, ÷Lëshimi i faturës tatimore, pika 1, ligjit nr. 92/2014 ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë neni 99 ÷Momenti i lëshimit të faturës, pika 1, pika 4 dhe UMF nr. 6, datë 30.01.2015 ÷Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, neni 20 ÷Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes, pika 2 dhe pika 3, nënpika 1.

**Sa më sipër, OE R Ndërtim sh.p.k. duhet të paguajë penalitetet në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, neni 114 ÷Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit, pika 1.**

**Pa llogaritur penalitetet për vonesat në deklarimin dhe pagimin e TVSH-së, si më sipër, si dhe faktin që faturat bashkë me situacionet nuk janë paraqitur çdo muaj, gjë që është detyrë e organeve tatimore, për faturat e paraqitura me vonesë konsiderohet se shërbimi ka përfunduar në momentin e lëshimit të faturës përfundimtare, pavarësisht nëse punimet janë marrë apo jo në dorëzim.**

BOE RN+V E, duhet të përfundonte kontratën jo më vonë se data 08.05.2018, datë në të cilën duhet të kishte përfunduar edhe dorëzimi i faturave, etj. Në kontratën për kryerjen e punimeve, në nenin 14 ÷Likuidimi i dëmeve, pika 14.1, përcaktohet se Tarifa ditore për dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve përtej afatit 30 ditor do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së saj. Për sa më sipër, për vonesat në dorëzimin e faturave, Autoriteti Kontraktor duhet të kishte llogaritur dhe mbajtur penalitetet në zbatim të kushteve të kontratës.

Në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë RN+V E, përmendet se volumet e punës do të jenë në raportin 73% për OE RN dhe 27% për OE V E. Fakti që të gjitha faturat janë paraqitur nga OE RN, do të thotë që operatorët ekonomikë e kanë tjetërsuar marrëveshjen e bashkëpunimit në marrëveshje nënkontraktimi dhe që të gjitha punimet janë kryer vetëm nga njëri prej OE, duke shkelur qëllimin e kontratës së bashkëpunimit duke vërtetuar në këtë mënyrë që kjo kontratë ka qenë vetëm me qëllim plotësimin e kriterëve të vendosura në DST, duke dëmtuar konkurrencën e drejtë. Nga ana tjetër, nqs do të

konsiderohej nënkontraktim, OE duhet të kishin paraqitur një aktmarrëveshje noteriale, të miratuar nga AK, sipas kërkesave të LPP, neni 61 *ōNënkontraktimiō* dhe VKM-së nr. 914, neni 75 *ōNënkontraktimiō*.

Në PV e kolaudit datë 19.09.2018, kolaudatori shprehet se nuk ka ndryshime në projekt dhe në preventiv, ndërkohë që duhet të ishte shprehur në lidhje me ndryshimet në projekt dhe punimet/materialet që janë hequr apo janë shtuar. *(Trajtuar në faqet nr13-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

### **16.1 Rekomandimi:**

Nga Bashkia Durrës të merren masa për të kërkuar menjëherë, në momentin e marrjes në dorëzim të mallit/punës/shërbimit, faturën me TVSH nga furnitori. Në rastet e punimeve në ndërtim të kërkojë çdo muaj faturën me TVSH, për çdo rast në përputhje dhe të rakorduar me grafikun e punimeve, situacionin, ditarin e punimeve, librezën e masave, etj., me qëllim moskrijimin e detyrimeve të prapambetura dhe përmbushjen e afateve kontaktuale.

**Në vijimësi**

**16.2 Rekomandimi:** Duke pasur parasysh që fondet për këtë prokurim kanë qenë në formë granti nga qeveria, me financim në vite, të verifikohet nëse fatura është paraqitur me vonesë për shkak të pamundësisë së pagesës nga ana e Autoritetit Kontraktor apo për shkaqe të tjera dhe në të ardhmen të mos ndërmerren investime, pavarësisht se cili është burimi i financimit, pa pasur më parë në llogarinë e vet fondet e nevojshme.

**Në vijimësi**

**16.3 Rekomandimi:** Nga AK Bashkia Durrës, të merren masa që, gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në rastet e bashkimit të OE, të kërkohet disponimi i burimeve njerëzore dhe teknike sipas llojit të punimeve/shërbimeve/produkteve që do të ofrojë secili nga anëtarët e BOE, sipas marrëveshjes së depozituar prej tyre për këtë qëllim, dhe faturimi të kërkohet nga secili prej OE pjesëmarrës, për secilin nga punimet/shërbimet/mallrat e furnizuar prej tyre, në përputhje me preventivin, grafikun e punimeve, librezat e masave, etj.

**Në vijimësi**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *“Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës”*, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në zërat e punimeve *ōShkallët e emergjencës me konstruksion metalik të përbërëō*, *ōMur tulle të lehtësuar dopio me ll.p. M 25ō*, *ōVeshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suvaō*, *ōHidroizolim me emulsion 2 duar bitum tarraca + tualetetō*, *ōFV pompë qarkullimi inverterō*, në vlerën **2,759,640 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 16841 prot datë 21.09.2017, të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Durrës dhe BOE *ōRNō SHPK & *ōV - Eō SHPK*. Trajtuar në faqet nr 13-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**1.1 Rekomandimi:**Nga Bashkia Durrës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,759,640 lekë pa tvsh** nga BOE *ōRNō SHPK & *ōV - Eō SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 16841 prot datë 21.09.2017 me objekt *“Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës”*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

**Menjëherë**

## C. MASA ADMINISTRATIVE

### C.1 PËR INSPEKTORATIN E MBROJTJES SË TERRITORIT VENDOR DURRËS:

1. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, përcaktuar në nenin 5, 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në: Nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i rekomandojmë, Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobëpër 1 (një) mbikëqyrës, 1 (një) kolaudator dhe 2 (dy) projektues, renditur si më poshtë:

-Lidhur me pasojat nga tërmeti, diferencat në punime, cilësinë e punimeve dhe parregullsitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për objektin: òRikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën "14 Nëntori", Bashkia Durrës ".

1. **z. GI, përfaqësues i mbikëqyrësit OE "E-G" shpk** në cilësinë e mbikëqyrësit të objektit òRikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën "14 Nëntori", Bashkia Durrës ".
2. **z. ĘC, përfaqësues i mbikëqyrësit OE "T" shpk**, në cilësinë e kolaudatorit të objektit òRikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën "14 Nëntori", Bashkia Durrës ".

-Lidhur me mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në hartimin e projektit teknik të objektit: òRikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën "14 Nëntori", Bashkia Durrës ":

1. **Z. HÇ**, në cilësinë e projektuesit të objektit òRikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën "14 Nëntori", Bashkia Durrës ".
2. **Znj. DD**, në cilësinë e projektuesit të objektit òRikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën "14 Nëntori", Bashkia Durrës ".

**Menjëherë**

### C.2 PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

2. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 23, të ligjit nr. 162/2020 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, òPër Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, me qëllim marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, ndaj 10 punonjësve, për procedurën e prokurimit me objekt òRikonstruksion dhe shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën 14 nëntoriò, Durrës, si vijon:

- Për shkelje të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2017, neni 57 *Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit*, pika 3 dhe neni 77 *Mbikëqyrja e kontratës*, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga: **z. NA, jurist, z. AK, specialist dhe z. AZh, specialist.**

- Për veprime dhe mosveprime, të cilat janë në kundërshtim me nenin 23 *Specifikimet teknike* të LPP, si dhe për shkelje të neni 57 *Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit* të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2017, pika 4, ngarkohet me përgjegjësi grupi i hartimit të dokumenteve të tenderit, **z. AT, zj. MS, zj. DD dhe z. HC.**

Gjithashtu, të gjithë personat e sipërpërmendur ngarkohen me përgjegjësi për moszbatimin e neni 12 të LPP, *Përgjegjësia e autoritetit kontraktorë*, pika 2.

- Për veprime dhe mosveprime, të cilat janë në kundërshtim me LPP, neni 20 *Mosdiskriminimi*, neni 23 *Specifikimet teknike*, neni 24 *Anulimi i një procedure prokurimi*, pika 1, germa ç), neni 45, *Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*, pika 3, germa a), neni 46 *Kualifikimi i ofertuesve*, pika 1, germa b) dhe neni 53, *Shqyrtimi i ofertave* pika 3, neni 55 *Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*, neni 66 *Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*, si dhe për shkelje të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2017, neni 26 *Kontratat për punë publike*, neni 57 *Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit*, pika 4 dhe neni 58 *Komisioni i vlerësimit të ofertave*, ngarkohet me përgjegjësi KVO, **z. ZhV kryetar, z. HK anëtar dhe z. SM, anëtar.**

**Menjëherë**

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **D.1 PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

1. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, përcaktuar në nenin 8, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, Kreu VII, pika III të Vendimit Nr.42, Datë 16.1.2008 *“Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”*, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në: Nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, i rekomandojmë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara me qëllim dhënien e masës disiplinore ndaj subjektit të licencuar në fushën e zbatimit të punimeve, për 1 (një) zbatues punimesh zbatimi, renditur si më poshtë:

-Lidhur me pasojat nga tërmeti, diferencat në punime, cilësinë së punimeve dhe parregullsitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në objektin: *“Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës ”*:

1. Subjektit, **RN” SHPK & “V - E” SHPK**, përfaqësuar nga Znj. EÇ, në cilësinë e zbatuesit të punimeve të objektit *“Rikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”, Bashkia Durrës ”*.

**Menjëherë**

2. Mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator ne fuqi, si dhe nënë nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i rekomandojmë Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë që referuar: i) shkeljeve të konstatuara mbi zbatimin e procedurave ligjore nga **Instituti i Ndërtimit**, për zbatimin e Vendimit nr. 32, datë 02.07.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit; ii) përgjegjësi individuale, të evidentuara dhe pasqyruara në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit; si dhe iii) komenteve të subjektit të audituar, të vlerësojë shkeljet e konstatuara me qëllim marrjen e masave disiplinore\administrative, në proporcion me këto shkelje.

**Menjëherë**

## **D.2. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK**

### **D.2.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE:**

1. Referuar Nenit 77, Mbikëqyrja e kontratës, të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar, ku citohet: "*Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti*" dhe nenit 23, të ligjit nr. 162/2020 *ōPër prokurimin publikō*, i ndryshuar, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i rekomandojmë, Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara me qëllim dhënien e masës disiplinore për: znj. ES, Znj. MS dhe Znj. DM, në cilësinë e certifikuesit të punimeve, lidhur me certifikimin e punimeve dhe parregullsi të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për realizimin e punimeve të objektit: *ōRikonstruksioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën "14 Nëntori", Bashkia Durrës"*.

**Menjëherë**

2. Referuar parregullsi dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 23, të ligjit nr. 162/2020 *ōPër prokurimin publikō*, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, *ōPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitō*, i rekomandojmë Bashkisë Durrës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur për marrjen e masave disiplinore, në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, ndaj 10 punonjësve, për procedurën e prokurimit me objekt *ōRikonstruksion dhe shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën 14 nëntoriō*, Durrës, për sa vijon:

- Për shkelje të nenit 57 *ōPersoni përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimitō*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2017, pika 3, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga: NA, jurist, AK, specialist dhe AZh, specialist;
- Për moszbatimin e nenit 57 *ōPersoni përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimitō*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2017, pika 4 ngarkohet me përgjegjësi Grupi i hartimit të dokumenteve të tenderit, AT, MS, DD dhe HC.

Gjithashtu, të gjithë personat e sipërpërmendur ngarkohen me përgjegjësi për moszbatimin e nenit 12 të LPP, *ōPërgjegjësia e autoritetit kontraktorō*, pika 2.

- Për veprime dhe mosveprime, të cilat janë në kundërshtim me nenin 23 *Specifikimet teknike* të LPP, si dhe për shkelje të nenit 57 *Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit* të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2017, pika 4, ngarkohet me përgjegjësi grupi i hartimit të dokumenteve të tenderit, AT, MS, DD dhe HC.
- Për shkelje të nenit 20 *Mosdiskriminimi*, nenit 55 *Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*, nenit 66 *Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*, të LPP dhe nenit 26 *Kontratat për punë publike* dhe nenit 58 *Komisioni i vlerësimit të ofertave*, të VKM-së nr. 914, pika 8, ngarkohet me përgjegjësi KVO-në, ZhV kryetar, HK anëtar dhe SM anëtar.
- Për shkelje të nenit 77 *Mbikëqyrja e kontratës*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2017, pika 3, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga: NA, jurist, AK, specialist dhe AZh, specialist.

**Menjëherë**

### **D.2.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësin e Bashkisë Durrës, z. VD, nuk rekomandojmë masë disiplinore pasi shkeljet e konstatuara, të cilat pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen, sepse personi i ngarkuar me përgjegjësi (në cilësinë e certifikuesit të punimeve), nuk është më në marrëdhënie pune me Bashkinë Durrës, dhe si pasojë nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të masës disiplinore, lidhur me certifikimin e punimeve dhe parregullsitë të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për realizimin e punimeve të objektit: *Rikonstrukcioni, shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën 14 Nëntori, Bashkia Durrës.*

### **E. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve, të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.*

**K R Y E T A R**

**Arben SHEHU**